

**RREGULLORE NR. 1999/4**

UNMIK/RREG/1999/4

2 shtator 1999

**PËR VALUTËN E LEJUAR PËR PËRDORIM NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, datë 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë të datës 25 korrik 1999,

Me qëllim të rregullimit të përdorimit të valutës në Kosovë,

Shpall sa vijon:

Neni 1

**LIRIA E LIDHJES SE KONTRATËS**

Palët që lidhin kontratë ose bëjnë çfarëdo transaksioni në baza vullnetare mund të realizojnë një transaksion të tillë në valutën për të cilën palët pajtohen. Përveç në rastet kur vërtetohet ndryshe, një marrëveshje e tillë konsiderohet e vlefshme në raport me cilëndo valutë të huaj në përdorim të gjerë në territorin e Kosovës.

Neni 2

**HEQJA E KUFIZIMEVE**

2.1 Çdo kufizim, sipas ligjeve në fuqi në territorin e Kosovës para datës 24 mars 1999, duke përfshirë çfarëdo kontrolli që është zbatuar mbi valutën e huaj, që ka të bëjë me posedimin, përdorimin apo mbajtjen e valutës, si me para në dorë (kesh), ose në bankë apo në çfarëdo lloj tjetër llogarie, si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Kosovës, me këtë rregullore shfuqizohet.

2.2 Në këtë nen “kufizimet” përfshijnë veprimet e dënueshme sipas neneve 114-119 ose të parapara a të përcaktuara në çdo dispozitë tjetër të Ligjit mbi përdorimin e valutës së huaj, “Gazeta zyrtare e Republikës Federative të Jugosllavisë” nr. 12/95, 28/96, 29/97, 35/97.

-

Neni 3

**BUXHETET, REGJISTRIMET DHE LLOGARITË FINANCIARE**

- Buxhetet, regjistrimet dhe llogaritë financiare të të gjithë personave fizikë e juridikë, duke përfshirë ndërmarrjet private, organet publike, agjencitë ose institucionet dhe UNMIK-un mbahen në valutën ose valutat e përcaktuara në përputhje me një direktivë administrative të shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm sipas nenit 5.

## Neni 4

**PAGESAT E DETYRUESHME**

4.1 Pagesat e detyrueshme mund të llogariten dhe të kërkohen për t'u paguar në një valutë apo disa valuta, siç përcaktohet në direktivën administrative të përmendur në nenin 3 më sipër.

4.2 Personi që dëshiron të paguajë një pagesë të detyrueshme me dinarë, e cila sipas nenit 4.1 kërkohet të paguhet me ndonjë valutë tjetër, mund ta bëjë këtë edhe me dinarë sipas kursit të këmbimit valutor në ditën e pagesës, por do të detyrohet të paguajë një taksë administrative shtesë për të mbuluar shpenzimet e procedurës dhe të transaksionit.

4.3 Në këtë nen:

- (i) “Pagesë e detyrueshme” do të thotë çfarëdo pagese, përveç pagesave të bëra në bazë të një kontrate apo ndonjë transaksioni tjetër vullnetar, e bërë në emër të një organi publik dhe përfshin pagesën e tatimeve, detyrimeve doganore dhe akcizave, taksave, tarifave, interesit për pagesë të vonuar dhe gjobave si dhe çdo lloj pagese tjetër që bëhet për shërbimet publike ose në bazë të një vendimi gjyqi;
- (ii) “Dinar” do të thotë valutë zyrtare e Republikës Federative të Jugosllavisë, lëshur nga Banka Kombëtare e Jugosllavisë sipas Ligjit të Bankës Kombëtare të Jugosllavisë, Gazeta zyrtare e Republikës Federative të Jugosllavisë” nr. 32/93, 35/93, 41/94, 61/95, 28/96, dhe 29/97, e vlefshme prej datës 3 korrik 1993, dhe në versionin e saj të tanishëm prej datës 5 korrik 1997 dhe
- (iii) “Kurs referues i këmbimit” do të thotë kursi i këmbimit ndërmjet dinarit dhe valutës së zgjedhur që përcaktohet herë pas here sipas kushteve të tregut.

## Neni 5

**ZBATIMI**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ka kompetencë të nxjerrë direktiva dhe urdhra administrative për zbatimin e kësaj rregulloreje.

## Neni 6

**LIGJI NË FUQI**

Neni 49 i Ligjit të Bankës Kombëtare të Jugosllavisë, nenet 8-10 të rregullores për dinarin e ri, Gazeta zyrtare e Republikës Federative të Jugosllavisë” nr. 6/94, 12/94 dhe 57/94, si dhe çdo kufizim apo ndalesë tjetër lidhur me përdorimin e valutës së huaj si para, si në llogari apo për pagesa, sipas ligjeve në fuqi në territorin e Kosovës para datës 24 mars 1999 nuk do të zbatohen më në Kosovë nëse bien në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

## Neni 7

**HYRJA NE FUQI**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 2 shtator 1999.

***Bernard Kouchner,***  
***Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm***